

## NJOFTIM

### **“PËR HAPJEN E REGJISTRIMEVE PËR APLIKIM PËR ANËTAR TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR (KIZ) DHE KOMISIONIT TË APELIT (KA) NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS.”**

Në zbatim të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Sporteve të Tiranës” me nr. 213/1 prot. të datës 10.02.2020, neni 6 dhe neni 38, Vendimit të Senatit Akademik të UST-së me nr.16 datë 12.02.2020 ftohen anëtarë të asamblesë akademike të njësisve kryesore të UST-së si dhe studentë të dy fakulteteve për të bërë regjistrimin pranë Sekretarit të Senatit Akademik, Prof.Asc.Dr. Robert Çitozi, Zv/rektor i UST-së si me poshtë:

1. Regjistrimi fillon në datën 13.02.2020 – 20.02.2020, nga ora 10.00-14.00;
2. Vendi i regjistrimit: Zyra e Zv/rektorit/ Prof.Asc.Dr. Robert Çitozi/ Sekretar i SA.
3. Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) ka gjithsej 5 anëtarë nga të cilët 4 (katër) janë nga asambleja akademike e njësisve kryesore dhe 1 (një) është student, të cilët do të përzgjidhen nga Senati Akademik i UST-së sipas listës së paraqitur nga Sekretari i Senatit në përfundim të afatit kohor të kandidimit.
4. Komisioni i Apelit (KA) ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, 2(dy) prej të cilëve i cakton Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, ndërsa 3 (tre) përzgjidhen nga asambleja akademike e UST-së. Të drejtën për të aplikuar për në KA e kanë:
  - Kanë përvojë pune në mësimdhënie, jo më pak se 5 (pesë) vjet, me kohë të plotë;
  - Nuk kanë qenë asnjëherë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë;
  - Nuk kane lidhje gjinore në vijë të drejtë ose të tërthortë, deri në shkallë të katërt, me kandidatë që konkurojnë në zgjedhje. Në rast konstatimi të tillë, anëtari dorëhiqet menjëherë dhe zëvendësohet nga Senati Akademik me short ose nga MASR.
5. Anëtari i KIZ/KA nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues dhe/ose për anëtar në organet drejtuese, të çdo niveli.
6. Për detaje dhe të dhëna më të hollësishme referojuni Rregullores së Zgjedhjeve të UST-së.

**SEKRETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof.Asc.Dr. Robert Çitozi**